



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.04/2017

Prishtinë, më 15 nëntor 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Lirije Kajtazi dhe Mytaher Haskuka,

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Albana Bajrami-RTK, Fitore Zena - Praktikante, Mira Avdimetaj-Arbëresh. Info, Gramoz Paqarada-KDI, Avdullah Shabani-Iniciativa qytetare, Agim Ibishi-Iniciativa Qytetare, Talat Hoxha - Iniciativa Qytetare, Shpresa Sejdiu - Asisente e Grupit VV, Lumnije Zeka-KRU „Prishtina”, Sokol Xhafa-KRU „Prishtina”, Regjep Zeka-OJQ „Sundimi i Demokracisë në Kosovë”, Avni Syla -Komuna Podujevë, Drita Hajdari - Prokurore, Flora Kryeziu - UNICEF, Hilmi Jashari - Avokat i Popullit, Burim Tahiri - IAP, Tafil Rrahmani-IAP, Dren Doli - GLPS, Njomza Arfifi - GSJP, Blend Zyrapi - KIPRED, Umberto Cucchi-GSJP dhe Francisco Garcia - GSJP.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Peticioneve, të ftuar: drejtori për Shërbime Publike, Komuna Podujevë, dhe përfaqësues të banorëve nga fshati Orllan;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016;
3. Takim i anëtarëve të Komisionit Funkcional me përfaqësues të Organizatës - Grupi

Për Studime Juridike dhe Politike;
4. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Peticioneve, të ftuar: drejtori për Shërbime Publike, Komuna Podujevë dhe përfaqësues të banorëve nga fshati Orllan

Duda Balje tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi në shqyrtim dy peticione.

a) Peticioni i parë është ai i përfaqësuesve të banorëve nga fshati Orllan, Komuna Podujevë

Ajo tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi të pranishëm përfaqësuesit e Peticionit, përfaqësuesin e Komunës së Podujevës dhe drejtorin teknik të Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal (KUR) - Prishtina, të cilët do të na njoftojnë më në detaje si qëndron problemi i ujit në atë rrethinë.

Rexhep Zeka, përfaqësues i OJQ “Sundimi i Demokracisë në Kosovë”, tha se banorët dhe vizitorët e kësaj zone ballafaqohen me mungesë të ujit që është element thelbësor në jetë, edhe pse ndodhemi afër rezervuarit të ujit që furnizon me ujë afër 600 mijë banorë të Kosovës. Në bazë të një hulumtimi që është bërë nga “OJQ Sundimi i Demokracisë në Kosovë” del se një pjesë e madhe e banorëve kanë migruar kryesisht në vendet urbane, ku 8 deri 10 familje migrojnë gjatë vitit dhe nëse vazhdon ky trend për disa vite do të zbrazen këto fshatra dhe kjo zonë do të mbetet e pabanuar.

Në fund të vitit 2011, në institucione të ndryshme kemi dërguar një petition me kërkesë për kyçje në ujësjellës, por deri më tani nuk ka rezultate konkrete, ndërsa në shkurt të këtij viti, kemi mbajtur një tryezë dhe kemi dalë me rekomandime, të cilat ia kemi dërguar Ujësjellësit Rajonal Prishtina, Ministrisë së Mjedisit dhe Komunës së Podujevës.

Në mungesë të veprimeve konkrete për këtë çështje jemi detyruar të mbajmë një protestë dhe t'i mbledhim nënshkrimet në mënyrë që të ju drejtohem sërish disa institucioneve përfshirë Kuvendin e Kosovës - Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Kryetari i komunës na ka premtuar se do të ndahen mjete për këtë projekt.

Jemi në dijeni se për këtë çështje janë zotuar 50 mijë euro për vitin e ardhshëm, ndërsa vlera e projektit është 1 milion e 300 mijë euro, lusim përfaqësuesit e komunës dhe të ujësjellësit që në koordinim të gjejnë mjete të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti në vitin 2018.

Avni Syla – nga Drejtoria për Shërbime Publike, Komuna e Podujevës, tha se është paraparë një shumë e caktuar prej 45 mijë euro, sipas kodit buxhetor për ndërtim dhe zgjerim të ujësjellësit. Mirëpo në kodin tjetër buxhetor për participim në projektet e përbashkëta me donatorë, për vitin 2018, kemi një shumë të participimit që për fillim është 84 mijë euro, nga të hyrat vetanake, të cilat mund të përdoren në rastin konkret. Komuna nuk ka pushuar duke kërkuar donacione për këtë projekt, në mars të këtij viti kemi pasur takim me organizatën zviceriane CDI, ku janë dakorduar që komuna e Podujevës të participojë me një pjesë të mjeteve, kurse pjesa tjetër do të jetë donacion nga asociacioni i përbashkët i CDI-së, ndërsa projektin do ta hartoj KUR Prishtina. Në qershor të këtij viti Drejtoria e Shërbimeve Publike e komunës i është drejtuar KUR – Prishtina për të informuar me hartimin e projektit ideor për kyçje të Orllanit në rrjetin e ujësjellësit.

Duda Balje pyeti se sa kushton implementimi i këtij projekti.

Avni Sylja tha se projektin do ta hartojë KUR-Prishtina, implementimi i projektit kushton diku 800 mijë deri 1 milion euro, por sipas marrëveshjes dhe premtimeve që i ka bërë organizata CDI, kjo organizatë do të sigurojë diku 500 mijë deri 600 mijë euro. Po ashtu, do të participojë Komunës e Podujevës, si dhe Ujësllësit Rajonal Batllava dhe presim donatorë të tjerë për implementimin e këtij projekti.

Sokol Xhafa tha se KRU furnizon 40% të popullsisë së Kosovës me ujë, ndërsa tani gjenden në një situatë jo të mirë financiare.

Për të arritur furnizimin e pjesës së Orllanit me ujë nevojiten 1.3 milion euro, dhe si ujësllës nga ana e jonë, do të kontribuojmë aq sa kemi mundësi.

Teuta Haxhiu pyeti përfaqësuesin e Komunës së Podujevës se a keni shkresë zyrtare përmes së cilës ju keni drejtuar qeverisë së kaluar për këtë projekt, apo nga kryetari i komunës, i cili edhe kishte ndikim në qeverinë e kaluar, çka ka bërë për të ndihmuar që këto fshatra të furnizohen me ujë dhe a keni marrë përgjigje nga qeveria e kaluar?

Frashër Krasniqi tha se diku nga viti 2011 e keni ngritur këtë shqetësim dhe shqetësuese është se për 7 vjet komuna nuk paska bërë asgjë në këtë drejtim. Banorët e asaj ane janë të privuar nga e drejta në ujë të pijes, duke e ditur që vendi i tyre e furnizon një pjesë të madhe të Kosovës me ujë. Do të presim se çka do të bëjë qeveria e tashme për zgjidhjen e këtij problemi. Ai tha se ka propozuar që Komisioni ta procedojë këtë çështje për shqyrtim në seancën e ardhshme plenare, para se të miratohet buxheti dhe të përfshihet ky projekt në buxhetin qendror, meqenëse komuna po arsyetohet në mungesë të buxhetit.

Mirjeta Kalludra tha se probleme me ujë ka pothuajse në të gjithë Kosovën, si në fshatra, ashtu edhe në qytete, sa i përket kërkesës që kanë bërë banorët e rrethit të Orllanit po shihet se paska një komunikim të vazhdueshëm mes banorëve të komunës dhe ujësllësit.

Është mirë të specifikohet se çka ka bërë komuna lidhur me peticionin në fjalë për furnizim të banorëve me ujë, a është problemi vetëm në mungesë të aspektit financiar apo mungesë gatishmërie e kryetarit dhe sipas komunës kur parashihet zgjidhja e këtij problemi?

Ne, si Komision, do ta shqyrtojmë projekt buxhetin për vitin 2018, dhe nëse pajtohen edhe anëtarët e tjerë të Komisionit do të bëjmë amendament që ky projekt për furnizim me ujë të këtyre banorëve të përfshihet në buxhet.

Mexhide Mjaku-Topalli u tha se komuna ka ndarë 45 mijë euro, do të ndihmoj CDI-ja, mirëpo pyeti se cilat janë shkaqet që nga viti 2011, nuk është filluar me projekt nga ana e kompanisë së ujësllësit, por vetëm tani keni filluar me projektin ideor.

Ajo më tej pyeti përfaqësuesin e KRU – Prishtina, që sa vite jeni në kredi, si kompani e ujësllësit për rezervuarin në Shkabaj.

Në fund ajo theksoi se me këtë problem nuk ballafaqohet vetëm ky rajon në Komunën e Podujevës, por edhe shumë fshatra të Komunës së Ferizajt.

Luljeta Veselaj- Gutaj pyeti se përfaqësuesit e qytetarëve, a kanë pasur bashkëpunim me komunën dhe cila ka qenë përgjigjja konkrete, a keni kërkuar mbështetjen edhe nga organizatat dhe investitorët e huaj që kanë gatishmëri për të investuar në Kosovë.

UNDP ka qenë e gatshme të investojë në këto çështje, dhe pse mungon një projekt konkret nga viti 2010.

Albulena Balaj-Halimaj u interesua të dijë se si do të zhvillohet çështja e këtij procesi. Ne duhet të dalim me një përfundim të përbashkët se si do të kontribuojmë në këtë çështje drejt zgjidhjes, sepse banorëve ju intereson se çka do të vendoset nga ky takim.

Teuta Haxhiu tha se nga përfaqësuesit e peticionit u tha se brenda vitit migrojnë 7-10 familje dhe po i bien që 350 banorë janë larguar, dhe nëse këto janë fakte të sakta, ky është një shqetësim shumë i madh.

Saranda Bogujevci u interesua të dijë se kur është bërë projekti, apo më saktë kur i është dorëzuar komunës, dhe a ka arsye pse është vonuar projekti aq shumë për të furnizuar këta banorë me ujë të pijes.

Avni Syla tha se Komuna e Podujevës ka 72 fshatra të banuara, arsye për mos intervenimin në fshatrat e Orllanit është kostoja e lartë buxhetore, nuk është një sistem i thjeshtë. Problem tjetër është edhe mungesa e ujit deri në ndërtimin e fabrikës së re, është një kërkesë shumë e arsyeshme e atyre banorëve, por deri tani në pamundësi buxhetore nuk është realizuar. Komuna ka ndarë buxhet faza-faza, për çështjen e furnizimit me ujë, por njëkohësisht komuna ka pranuar edhe kërkesa nga fshatra të tjera.

Kryetarja: Më sa kuptova CDI është e gatshme të ndihmojë me gjysmën e mjeteve dhe se projekti është hartuar, dhe a keni nënshkruar marrëveshjen?

Avni Syla tha se është marrëveshja mes Kryetarit të Komunës, përfaqësuesve të CDI-së dhe përfaqësuesve të Ujësjiellit, nuk është në dijëni për nënshkrimin.

Sokol Xhafa tha se me CDI- në, kanë pasur marrëveshje në përgjithësi, ka qenë faza e 5- të që përmbyllet këtë vit. Për Orllanin në mënyrë specifike nuk ka marrëveshje. Ka pasur diskutim me kryetarin e komunës, por nuk ka pasur zotim se do të ndahen mjete specifike për Orllanin. Sa i përket Projektit për Orllanin ai është dorëzuar në Komunën e Podujevës, në shtator të vitit 2017.

Avni Syla tha se personalisht nuk është në dijëni që zyrtarisht kanë pranuar si komunë ndonjë projekt për ujësjellësin e Orllanit.

Frashër Krasniqi propozoi që çështja e peticionit të banorëve të fshatrave të Orllanit të procedohet si pikë e rendit të ditës në seancë plenare.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e lartpërmendur të deputetit Frashër Krasniqi.

Rezultati i votimit ishte: Për ----- 3 vota
Abstenime ----- 4 vota,
Kundër -----0 vota.

Kryetarja konstatoi se nuk miratohet propozimi që kjo çështje të procedohet si pikë e rendit të ditës në seancë plenare.

Pastaj Komisioni vendosi të kërkoj nga Komuna e Podujevës sqarime shitesë lidhur me aspektet buxhetore, afatet kohore dhe mundësinë e realizimit të projektit për furnizim me ujë të pijes të fshatrave të Orllanit.

b) Kërkesa e znj. Drita Hajdari, prokurore

Kryetarja tha se lidhur me kërkesën e lartpërmendur e kemi ftuar në Komision znj. Drita Hajdarin, e cila do të na njoftojë lidhur me kërkesën e saj.

Drita Hajdari tha se ka bërë ankesë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, në lidhje me mos përgjigjen e Avokatit të Popullit, ku ka kërkuar opinionin e tij lidhur me ligjshmërinë e disa çështjeve, që kanë të bëjnë me lejimin e qasjes në një komunikim zyrtar elektronik të saj.

Gazetari ka kuptuar për ekzistimin e këtyre e-mailave dhe i është drejtuar zyrtarit për qasje në dokumente publike në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përmes e-mailit dhe është thirrur në ligjin për qasje në dokumente publike.

Kjo ka ndodhur në vitin 2014 dhe gazetari ato e-maila i ka përdorë për qëllime private për padi civile.

Me pranimin e padis civile në vitin 2016 fillimisht kam kontaktuar Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale, ku ata kanë deklaruar se nuk janë kompetent për interpretim të ligjit për qasje në dokumente publike.

Më 1 prill 2016 i jam drejtuar me një shkresë Avokatit të Popullit, i kam paraqitur situatën, kam shprehur shqetësimin sepse është e rrezikshme nga aspekti i lirisë dhe të drejtave të njeriut.

Më pas, kam realizuar edhe disa takime me Avokatin e Popullit, ku kam shprehur shqetësimet, që nuk janë vetëm personale.

Avokati i Popullit ka autorizuar një zyrtare dhe e ka bërë një raport, por Avokati i Popullit nuk e nënshkruan, se kinse nuk është raporti profesional.

Pas kalimit të afatit dhe mos përgjigjes së Avokatit të Popullit kam marrë idenë të drejtohem në Komisionin tuaj.

Luljeta Veselaj- Gutaj pyeti se çka konkretisht si komision mundemi me bërë në këtë rast, cila është kërkesa e juaj për Komisionin?

Drita Hajdari tha se meqenëse e mbikëqyrni punën e IAP-it, atëherë kërkon nga Avokati i Popullit, të më kthej përgjigje.

Teuta Haxhiu, pyeti se për më shumë se një vit kërkon përgjigje, dhe nuk keni pranuar që të ballafaqoheni me Avokatin e Popullit, kjo është shqetësuese.

Kryetarja tha se do të bisedojmë këtë çështje edhe me Avokatin e Popullit, do të kërkojmë nga IAP-i, një përgjigje në formë të shkruar dhe do t' ju informojmë edhe ju.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Kryetarja tha se për këtë pikë të rendit të ditës e kemi prezent edhe Avokatin e Popullit, i cili do ta bëjë prezantimin e Raportit para Komisionit.

Hilmi Jashari tha se ky Raport është proceduar duke respektuar afatin ligjor dhe siç e parasheh Ligji, por që nuk ka arritur të procedohet për shkak të shpërbërjes së legjislaturës së kaluar të Kuvendit.

Ai bëri një zbërthim të plotë të Raportit vjetor për vitin 2016, i cili bazohet në disa shtylla, siç janë: gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, të drejtat e fëmijëve, liritë fetare, barazia gjinore, mos diskriminimi, mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, përmbledhjen e raporteve me rekomandime të nxjerra nga IAP-i, aktivitetet e IAP-it, si dhe bashkëpunimin e këtij institucioni me avokatin e popullit të Shqipërisë dhe të shteteve të tjera në rajon dhe më gjerë.

Në kuadër të mandatit të IAP-it, gjatë këtij viti raportues janë adresuar 173 rekomandime, për institucionet publike të Republikës së Kosovës, e dhënë kjo e cila paraqet një rritje prej 203% në krahasim me vitin paraprak, tha ai.

Po ashtu ai theksoi se është shënuar rritje, në nivelin prej 100% të rasteve të hetuara ex-officio, në krahasim me vitin e kaluar raportues, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me shkelje sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Më tej, ai theksoi se sa i përket ligjeve, shpeshherë ligjet janë në kolizione të drejtpërdrejta mes veti dhe pastaj është shumë vështirë që autoritetet gjyqësore të japin ndonjë interpretim korrekt.

Sa i përket sistemit gjyqësor, ky sistem përballet me zvarritje të proceseve gjyqësore, nëpër gjykata janë 173 mijë lëndë të pashqyrtuara që është shumë shqetësuese.

Sa i përket besimit të qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit, në rajonin e Ballkanit, Kosova del e para.

Në lidhje me çështjen e pagesave të veteranëve të luftës ai tha se si institucion ka sugjeruar që vendimi i qeverisë t'i nënshtrohet një procesi gjyqësor dhe kjo i jep vlerë më shumë statusit të veteranit.

Teuta Haxhiu vlerësoi lart çështjen e besueshmërisë së qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, në raport me vendet e tjera të Ballkanit.

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2016, e paraqet gjendjen reale.

Ajo theksoi se mbështet idenë që Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, mos të votohet në seancë plenare dhe besoj se kjo do të rregullohet me rregulloren e re të Kuvendit.

Frashër Krasniqi: Raporti është i punuar mirë dhe reflekton punën e mirë të IAP, është shqetësuese që në përgjithësi Institucionet Publike nuk i marrin me seriozitet rekomandimet kërkesat dhe vërejtjet e Avokatit të Popullit, ndërsa detyrë e jona si Komision dhe si Kuvend, është që të ndikojmë në Institucione, që të marrin në konsideratë trajtimin e rekomandimeve dhe kërkesave të Institucionit të IAP, dhe të zbatohen ato.

Luljeta Veselaj tha se sa i përket punës në sektorin privat, me theks të veçantë te gjinia femërore, kur kuptohet se ajo është në proces të martesës apo edhe të lehonisë, paraqiten ankesat dhe aty këtu bëhet presion që ajo të largohet nga puna, apo edhe pas lindjes nuk paguhet as pushimi i lehonisë.

Këtë çështje e kam diskutuar edhe në seancë plenare.

Ajo theksoi se problem paraqet mos harmonizimi i ligjeve, siç është Ligji për shërbimin civil dhe Ligjit për arsim, sa i përket çështje për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave.

Raste të tilla ka pasur në Komunën e Prizrenit, ku një vit ka pasur diskutim kush duhet t'i zgjedh drejtorët nëpër shkolla të Komunës, derisa janë sqaruar pak a shumë gjërat.

Ajo kërkoi të dijë një opinion të Avokatit të Popullit se cili ligj jep më shumë të drejtë, lidhur me çështjen e lartpërmendur.

Miljana Nikoliq, tha se me rastin e analizimit të raportit të Avokatit të Popullit, kam vërejtur se i njëjti përmban, siç tha ajo, informata gjysmake, të cilat nuk paraqesin realitetin.

Me gjithë respektin për komunitetet tjera, unë me këtë rast do të përqendrohem ekskluzivisht vetëm për komunitetin serb, përfaqësuese e të cilit edhe jam.

Ajo tha se e demanton pohimin e Avokatit të Popullit se në Veriun e Kosovës, shqiptarët dhe komunitetet tjera jo serbe nuk kanë mjaftë përfaqësues në nivelin komunal dhe se nuk janë mjaftë të kyçur në procesin e vendimmarrjes.

Se kjo nuk është e saktë, ajo mori me shembullin e Komunës së Mitrovicës Veriore, ku prej 19 këshilltarësh komunal, 6 prej tyre janë nga komunitetet pakicë atje, kurse prej këtyre, 5 janë shqiptarë, me sugjerimin se në Veri, serbët përbëjnë 90% të popullatës.

Gjithashtu, nga të gjitha kërkesat e drejtuara Komunës së Mitrovicës veriore, për renovim të shtëpive dhe për ndihmë sociale, 55% të tyre janë realizuar në favor të qytetarëve komuniteteve të pakicave.

Raporti "Ex Officio" i Avokatit të Popullit nuk përmban asnjë rast të serbëve të kthyer të cilët për çdo ditë ballafaqohen me probleme.

Raporti i Avokatit të Popullit nuk përmban gjithashtu asnjë rast të uzurpimeve të banesave dhe të pronave të paluajtshme pronarë të së cilave janë serbët.

Raporti i Avokatit të Popullit nuk merret me problemet e dokumenteve personale me të cilat ballafaqohen serbët dhe se në të nuk ka asgjë për personat e zhdukur të kombësisë serbe, familjet e të cilëve, për ta realizuar kompensimin në të holla, krahas dokumenteve të domosdoshme, janë të detyruar të bashkëngjisin edhe kopjen e letërnjoftimit serb si dhe faturën e rrymës elektrike. Kjo gjë, iu kërkohet vetëm familjeve serbe, tha ajo.

Hilmi Jashari tha se sa i përket pagesës së rrymës për serbët në veriun e Kosovës, atij i ka interesuar, nëse qytetarët e vendit, para Kushtetutës janë duke u trajtuar njëjtë sa i përket shfrytëzimit të rrymës elektrike. Raporti i Avokatit të Popullit, konstaton se qytetarët e vendit me 4.5% të vlerës së faturës së tyre ngarkohen me shpenzimet e rrymës në veriun e Kosovës. Këtë pretendim e konfirmon edhe ZRRE, dhe thonë se ekziston një vendim nga vitit 2012, i cili humbjet në veri i klasifikon në konceptin e humbjeve komerciale, sipas ligjit për energjinë, e që kjo i bie se është vjedhje e energjisë elektrike dhe kjo është vepër penale.

Sa i përket personave të zhdukur, ai tha se kjo situatë i referohet viti 1998-1999, ndërsa dihet se Institucioni i Avokatit të Popullit është themeluar në vitin 2000, dhe në bazë të këtij ligji nuk mund të merremi me ngjarjet që kanë ndodhur para themelimit të Institucionit, sepse është kriter ligjor dhe kjo çështje është jashtë mandatit të Avokatit të Popullit.

Në lidhje me informacionet rreth personave të zhvendosur, ai theksoi se kemi kërkuar të bëhet një ligj i veçantë për persona të zhvendosur.

Në fund, Avokati i Popullit, ftoi znj. Miljana Nikoliq në Institucionin që ai përfaqëson, për të dhënë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me çështjen e personave të zhvendosur.

Duda Balje sa i përket çështjes së kthimit tha se ekziston Ministria e Kthimit në Republikën e Kosovës, e cila ka një buxhet të madh, përmes së cilës mund të adresohen këto çështje. Po

ashtu komuniteti serb kanë edhe zëvendëskryeministër, ndërsa komunitetet e tjera pakicë janë më të diskriminuar se serbët.

Sa i përket termit të ashtuquajtur “Kosovo i Metohija”, të theksuar nga Miljana Nikoliq, ajo tha se nuk ekziston termi i tillë. Këtu jemi deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkoj nga ajo, që të respektohet emri Kushtetues i Kosovës.

Saranda Bogujevci tha se si deputet jemi përfaqësues të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe nuk jemi të ndarë si deputetë të komuniteteve të caktuara, e shoh veten si deputete të Republikës së Kosovës dhe i përfaqësojmë qytetarët e gjithë vendit.

Albulena Balaj-Halimaj u tha se janë 173 mijë lëndë të pashqyrtuara nëpër gjykata dhe këto lëndë as që përmenden në raportet vjetore të gjykatave dhe kjo është shumë shqetësuese.

Po ashtu foli për dhunën nëpër shkolla edhe kjo është shqetësuese, në raport janë trajtuar 4 raste, por që ka shumë më shumë, por për shkak të mungesës së raportimit nuk dihen.

Ajo tha se në të ardhmen do të duhej të punohet më shumë në fushën e sensibilizimit dhe vetëdijesimit për të drejtat e qytetarëve.

Mexhide Mjaku-Topalli, vlerësoi shumë të mirë bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit me Komisionin Funkcional.

Një rekomandim që ka dalë nga raporti e kam ngritur edhe në Kuvend, për njohjen e statusit të dëshmorëve në periudhat 1968 dhe para luftës, dhe kemi informatë se MPMS ka dhënë një përgjigjeje pozitive për këtë çështje.

Ajo më tej shfaqti brengosje se pse Ligji për barazi gjinore nuk po gjen zbatim të plotë, dhe se nuk është në harmoni me Ligjin për zgjedhjet lokale dhe Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, dhe shtroi çështjen e harmonizimit të këtyre ligjeve mes vete, nga se ende po funksionon 30% e përfaqësimit të gjinisë femërore nëpër lista zgjedhore.

Mirjeta Kalludra, u diskutua për energjinë elektrike, dhe si Komision do ta kemi një pikë të veçantë në mbledhjen e radhës lidhur me këtë çështje. Megjithatë, nëpër media po diskutohet se ky problem është edhe me ujin dhe nëse këto janë të vërteta, atëherë si institucion a do të ndërmerri masa? Sa i përket komuniteteve, mendoj se komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas janë komunitetet më të shkelura, gjendja e tyre është e rëndë, nuk vijojnë shkollën, kanë martesë të hershme dhe si shoqëri duhet të merremi më shumë me këto komunitete.

Hilmi Jashari, në përgjigjen e tij lidhur me çështjen e faturave të furnizimit me ujë, theksoi se çështja është në fazën e hetimeve.

Sa i përket ligjit për Barazi Gjinore, në mënyrë eksplicite, obligon të gjitha institucionet pa dallim të kenë përfaqësimin gjinore 50 me 50.

Kryetarja, në fund, hodhi në votim Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte: Për -----8 vota
Abstenime -----1 votë,
Kundër -----0 vota.

Kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Kuvendi të miratojë Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

3. Takim i anëtarëve të Komisionit Funkcional me përfaqësues të Organizatës - Grupi Për Studime Juridike dhe Politike

Kryetarja falënderoi në emër të Komisionit Funkcional dhe në vazhdim ia dha fjalën përfaqësuesve të kësaj organizate.

Dren Doli tha se në bashkëpunim me institutin KIPRED por edhe me Avokatin e Popullit, kemi përgatitur një Raport, qëllimi i të cilit është që të vendos një mekanizëm të përcjelljes së zbatimit të vendimeve të Avokatit të Popullit, i cili do të jetë mekanizëm interaktiv dhe do të jetë i hapur për publikun.

Kemi hartuar një raport i cili adreson disa prej problemeve shumë të mëdha që eksitojnë në përgjithësi me legjislacion mbi të drejtat e njeriut dhe mbi mandatin e Avokatit të Popullit, dhe kolegu do t'i prezantojë disa prej rekomandimeve.

Francisco Garcia tha se kemi disa rekomandime që kanë të bëjnë me të Drejtat e Njeriut, ku parashihet ta trajnojmë administratën dhe gjyqtarët nga kjo fushë dhe mbi zbatueshmerinë e ligjeve në praktikë.

Ka një numër të amendamenteve dhe interpretimeve ligjore që mundën t'i zgjidhin këto mospërputhje të vogla pasi që ligjet ekzistojnë, mundën të zbatohen, por nuk janë duke u zbatuar, Ligji për Barazi Gjinore jep barazi 50% të përfaqësimit gjinor.

Ligji elektoral thotë se së paku 30% duhet të jenë femra, dhe në raport me ligjin e lartpërmendur, cili ligj zbatohet, janë në kontradikta njëri me tjetrin.

Një tjetër e gjetur është se nuk ka mekanizëm për të përcjellë të drejtat e njeriut. Kemi herë pas here lansimin e një projekti apo një tjetri, por në rrafshin praktik puna shpesh edhe ngec, kjo nuk bëhet në mënyrë sistematike dhe periodike.

Indikatorët për të drejtat e njeriut janë të zhvilluara nga kombet e bashkuara dhe duhet t'i shfrytëzojmë edhe këto mekanizma, sepse janë shumë të mira, duhet t'i aplikojmë gjërat që e dimë që funksionojnë mirë.

Sa i përket qasjes në dokumente publike duhet të merret parasysh rishikimi i ligjit, pasi që ka disa situata të paqarta.

Duda Balje falënderoj për raportin dhe tha se çka konkretisht mundeni me e ndihmuar Komisionin Funkcional.

Dren Doli tha se ideja e projektit është rritja e kapaciteteve të IAP, në mënyrë që Avokati i Popullit, të ketë në dispozicion disa prej mjeteve për raportim më të lehtë në drejtim të Komisionit. Si institut jemi të gatshëm edhe me KIPREDIN, të afrojmë ndihmë profesionale, në aspektet për të cilat kemi kapacitete të brendshme, nëse Komisioni mendon se ka ndonjë fushë që nevojitet, ndonjë studim i hollësishëm mbi ndonjë çështje të caktuar.

Frashër Krasniqi tha se ka diskrepancë në mes të ligjeve. Kjo flet për një problem tjetër që është më i thellë, e që ka të bëjë me atë se ligjet në Kosovë nuk janë bërë si rezultat i një vullneti të brendshëm, i një strategjie të qartë për implementimin e të drejtave të njeriut, por si rezultat i ndikimeve të jashtme, qoftë si rezultat që lidhet me integrimin në BE, qoftë si çështje të tjera.

Njomza Arifi tha se një nga komponentët e projektit është edhe ngritja e bashkëpunimit institucional dhe ndihma për IAP-in, në mënyrë që të ngrihet bashkëpunimin me Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Do të monitorojmë jo vetëm rekomandimet e IAP por edhe të të gjitha institucioneve gjyqësore dhe jo gjyqësore dhe për t'u ngritur transparenca në përgjithësi.

Duda Balje, falënderoi prezantuesit e Grupit për Studime Juridike dhe Politike për gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me Komisionin FunkSIONAL.

Ajo tha se kur kemi ndonjë çështje të caktuar, kur do të nevojitet ndihma e tyre do t'ju kontaktojmë.

Të ndryshme

Kryetarja njoftoi që më 20 nëntor 2017, do të mbahet seanca e udhëhequr nga fëmijët, me rastin e shënimit të ditës së Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Ajo konstatoi se çështja e faturimit të energjisë elektrike për veriun e Kosovës, të vendoset si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e radhës.

Për këtë pikë të ftohet në Komision Avokati i Popullit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje